

AKT-THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
"THE BLUE EYE" SHPK

Sot në datë 22-01-2024 mbështetur në kërkesat e ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 **Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare**", me vullnetin tonë të lirë ramë dakord të themelojmë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K) me emrin **THE BLUE EYE" sh.p.k**, e cila do të veprojë sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 1

Themeluesit e shoqërisë

Themeluesit e shoqërisë janë:

- **Z. Bashkim Shalla**, shtetas shqiptar, lindur më 29 Gusht 1976, në Librazhd dhe banues në Tiranë, i identifikuar nga karta e identitetit me Nr personal H60829124N, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 2

Personaliteti juridik

1. Shoqëria **THE BLUE EYE" SHPK**, nga këtu e më poshtë referuar si shoqëria, e fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR).
2. Shoqëria është person juridik shqiptar e cila zhvillon aktivitetin në përputhje me ligjin nr. 9901 dt 14.04.2008 **Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare"** dhe këtë Statut.

Neni 3

Objekti i aktivitetit

Objekti i aktivitetit të shoqërisë është:

- a. Prodhim, ambalazhim, tregtim, brenda dhe jasht territorit të Republikës së Shqipërisë, të Ujit me dhe pa gaz. Prodhim shishe plastike, për përdorimin nevojave të aktivitetit të prodhimit, ambalazhimit, tregtimit të Ujit e pijeve freskuese. Prodhimin dhe ambalazhimin e pijeve freskuese me dhe pa gaz, si dhe të lengjeve të ndryshëm me shije frutash, pijeve energjike, etj. Shoqëria mund të kryej edhe veprimtari të tjera ndihmëse të cilat mbështesin arritjen e qëllimit të saj kryesor në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- b. "Shoqëria" do të japë konsulence biznesi në fushën e Investimeve, financiare për kompani dhe individë që ushtrojnë aktivitet në republikën e Shqipërisë por jo vetëm."

- c. Konsulenca per strukturim ose ristrukturim, planifikim dhe zhvillim te menyres se organizimit te kompanive.
- d. Konsulence financiare dhe jo vetem per pregatitjen e kompanive te operojne ne tregjet financiare brenda dhe jashte vendit.
- e. Shoqëria, brenda kufijve ligjorë, mund të kryejë çdo operacion që lidhet me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, trull (blerje, dhenie me qera, shitje).
- f. Aktivitete të tjera ndihmëse, te ndërvarura apo në funksion të aktiviteteve të mësipërme.
- g. Shoqëria mund të marrë pjesë në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose tërthortë në cdo shoqëri që ka objekt të ngjashëm apo që lidhet me objektin e Shoqërisë. Për këtë qëllim, shoqëria mund të bashkëpunojë me/ose në cdo mënyrë tjetër, të drejtëpërdrejtë ose tërthortë, të marrë pjesë në shoqëri të tjera që kanë objekt të ngjashëm ose që kanë lidhje me objektin e shoqërisë ose ndihmës për realizimin e objektit të shoqërisë. Shoqëria për të garantuar detyrimet e veta dhe ato të palevë të treta mund të vendosë garanci, si peng ose barrë hipotekore, përfshirë aktivitetin e saj. Në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë cdo aktivitet ekonomik, financiar, veprime me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, plotësisht ose pjesërisht, cdo tregti ose aktivitet tregtar dhe të zhvillojë cdo tregti ose aktivitet tjetër fitimprures I cili mund të jete fitimprurës në lidhje me aktivitetet tregtare të shoqërisë.
- h. Shoqëria mund të angazhohet gjithashtu në cfarëdo lloj aktiviteti tjetër që nuk ndalohet me ligj.

Neni 4

Selia e shoqërisë

1. Shoqëria ka selinë e saj në adresën: **Rruga Grigor Heba" ND 7; Tirana Albania**
2. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: **bashkim.shalla@gmail.com**

Neni 5

Kohëzgjatja e shoqërisë

1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është për një periudhe kohore të pakufizuar. Shoqëria fiton personalitetin juridik dhe mund të fillojë veprimtarinë e saj pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2. Çdo ndryshim në lidhje me periudhën e aktivitetit mundet të bëhet vetëm nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

Neni 6

Të dhënat në korrespondencat dhe dokumentet e tjera të veprimitarisë

Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:

- a) numrin unik të identifikimit (NUIS/NIPT);
- b) formën ligjore të shoqërisë;
- c) vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;
- d) të dhëna nëse shoqëria është në likuidim.
- e) Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

Neni 7

Kapitali Themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është **ALL 10 000 000.00 (dhjetë milion lekë)**. Kapitali i nënshkruar do të transferohet ose derdhet në llogaritë bankare të shoqërisë nga Ortaku i Vetëm jo më vonë se 90 ditë nga themelimi i kompanisë dhe jo më vonë se 60 ditë nga rregjistrimi I saj në regjistrin tregëtar (QKB).
2. Ortaku **Bashkim Shalla** është zotërues i **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme **ALL 10 000 000.00 (dhjetë milion lekë)** që përbën 100% të kapitali themeltar të shoqërisë.

Neni 8

Organet e shoqërisë

Drejtimi dhe administrimi i shoqërisë bëhet nëpërmjet organeve të saj që janë:

- Administratori i Përgjithshëm .
- Asambleja e Përgjithshme.

Neni 9**Administratori i Përgjithshëm**

1. Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si Administrator të Përgjithshëm të Shoqërisë, sipas Nenit 81 paragrafi(1) pika 3 dhe nenit 95 të Ligjit.
2. Shoqëria administrohet nga administratori i cili ka për detyrë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të Shoqërisë.

Shoqëria do të drejtohet, deri në datë 30.12.2029 nga Administratori:

Z. **Bashkim Shalla**, shtetas shqiptar, lindur më 29 Gusht 1976, në Librazhd dhe banues në Tiranë, i identifikuar nga karta e identitetit me Nr personal H60829124N, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Specimenti i nënshkrimit të Administratorit z. Bashkim Shalla është

Neni 10**Emërimi i administratorit**

1. Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
2. Administratori është person fizik i cili mund të zgjidhet edhe jashtë bashkësisë së ortakëve të shoqërisë.

Neni 11**Kohëzgjatja e mandatit**

1. Akti për emërimin e administratorit përcakton gjithashtu dhe kohën e qëndrimit në detyrë të tij. Nëse kjo nuk është e përcaktuar në aktin e emërimit, kjo periudhë nuk mundet të jetë më e gjatë se pesë vjet, duke filluar ky afat nga data e emërimit.
2. Në rast dorëheqje/shkarkimi Asambleja e Përgjithshme, jo më vonë se 2 javë nga momenti i njoftimit të dorëheqjes ose shkarkimit, emëron me vendim Administratorin e ri të shoqërisë.

Neni 12**Kompetencat e Administratorit**

1. Administratori ka kompetenca të plota për të vepruar në çdo rrethanë në emër të shoqërisë, gjithmonë brenda objektit të aktivitetit të shoqërisë, duke u kufizuar në ato kompetenca që ligji ose ky Statut ia jep shprehimisht Asamblesë së Përgjithshme.
2. Administratori i shoqërisë ka këto të drejta dhe detyrime:
 - a) përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët,
 - b) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë; duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
 - e) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
3. Shitja dhe/ose blerja e pasurive të paluajtshme do të konsiderohet e vlefshme nëse për të është marrë pëlqimi paraprak i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Në këtë rast vendimi përkatës i Asamblesë do të konsiderohet i vlefshëm, nëse ortakët që përfaqësojnë të paktën 51% të kapitalit të shoqërisë, kanë votuar në favor të shitjes dhe/ose blerjes së pasurisë në fjalë.
4. Administratori ka të drejtë të hapë llogari bankare, ti administrojë këto llogari pranë bankave të nivelit të dytë që operojnë në Republikën e Shqipërisë, kryen pagesa/transferta dhe jashtë kompanisë deri në vlerën maksimale totale EUR/Dollar 100,000 (Njëqind mijë euro ose dollar) në muaj ose ekuivalentin në monedha tjera. Për pagesa mbi këtë shumë nevojitet miratimi me shkrim i asamblesë së ortakëve sipas pikës (3) më sipër.

5. Administratori përgjigjet për ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve të shoqërisë, duke përfshirë vendimet dhe procesverbalet e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 13

Prishja e shoqërisë

Shoqëria do priset:

- a) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- b) me hapjen e përfundimin e procedurave të falimentimit/likuidimit;
- ç) në raste të parashikuara nga ligji në fuqi ;
- c) me vendim të gjykatës.

Neni 14

Likuidimi i shoqërisë

Likuidimi i shoqërisë kryhet në përputhje dhe në respektim të kushteve dhe procedurave të parashikuara nga dipozitat përkatëse ligjore.

Neni 15

Fuqia e akteve

Të gjitha çështjet për të cilat Statuti nuk i parashikon ose nuk i rregullon në mënyrë të posaçme do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” të cilat parashikojnë mënyrën e organizimit, funksionimit dhe kontrollit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR

“THE BLUE EYE” Sh.p.k

BASHKIM SHALLA

